

TË JETOSH NË NJË VEND

E drejta e familjes

E drejta e bjës

E drejta e arqëtimit

KU KA BARAZI

DEMOKRACIA, UDHËHEQJE E POPULLIT

EDON (11), ALBIN (12), KRON (13), BLEND (11), ALMA (11), BLEART (11), BERAT (13)



Nëse jeni të interesuar të dini se pse është e rëndësishme të jetoni në një shtet demokratik, lexojeni artikullin më poshtë

Të jetosh në demokraci do të thotë të jetosh i lirë dhe të shprehësh mendimet e tua lirshëm. Demokracia është udhëheqje e popullit. Por, shtrohet pyetja se si udhëheq populli? Populli udhëheq me anë të votave, ku të drejtën për të votuar e ka çdo njeri mbi moshën 18 vjeçare.

Demokracia për herë të parë është shfaqur në vitin 507 p.e.s., ku në atë kohë të drejtën e votës e kishin vetëm të pasurit dhe burrat, ndërsa gratë nuk e kishin këtë të drejtë. Kjo nënkupton se në filltet e para të demokracisë nuk ka pasur demokraci të plotë. Ajo që demokracia ka tentuar të arrijë është barazia, që i bie se të gjithë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa marrë parasysh gjininë, racën, fenë etj.

Demokracia ka mundësuar që jeta jonë të jetë me shumë ngjyra, sepse në ngjyrat e demokracisë përfs-

hihen: liria, toleranca, respekti, solidariteti, barazia etj.

Ne jemi shumë të lumtur që jetojmë në një shtet demokratik. Shteti ynë, Kosova ka demokraci të llojit përfaqësues me sistem parlamentar, që i bie se populli votën e tij ia beson deputetëve, të cilët në Kuvend miratojnë ligjet të cilat ndikojnë në jetën e secilit qytetar. Ky ndikim vërehet në zhvillimin e të gjithë shtetit, për shembull me anë të ligjeve që miratohen në Kuvend kemi arsim më të mirë, kushte më të mira mjekësore si dhe zhvillim më të mirë ekonomik.

Por, e gjithë kjo mund të arrihet me ndihmën e vazhdueshme të popullit i cili e ka kurorën, sepse e ka fuqinë më të madhe për të vendosur për të ardhmen e tij.


Duke u nisur nga kjo që e mësuat më lart ne kemi një mesazh për ju: qytetarë të dashur, na ndihmoni që ta rrisim edhe më shumë vlerën e demokracisë, sepse fjala jonë ka peshë dhe vlerë shumë të madhe.



Kuvendi është shtëpia e popullit




Ne jemi e ardhmja e vendit



Populli voton përfaqësuesit e vet




Forma e parë e demokracisë u shfaq në vitin 507 p.e.s.



Voto, sepse ndikon në të ardhmen tënde!



Barazia në demokraci



Numri i deputetëve në Kuvendin e Kosovës



Përkushtimi ynë gjatë punës në grup

INSTITUCIONI MË I LARTË LIGJVËNËS

ERITA (11), ENIS (11), LUM (12), LORES (11), ARIDON (11), TRINGA (11), JON (11)



A dëshironi të dini diçka më shumë për Kuvendin, për funksionet e tij dhe rëndësinë që e ka ai në një vend demokratik? Nëse po, atëherë lexoni këtë artikull

Për një shtet më të përparuar duhet të kemi të drejta të barabarta. Këto të drejta na mundëson demokracia, si formë e qeverisjes ku populli ushtron sovranitetin e tij me anë të zgjedhjes së përfaqësuesve.

Organi më i lartë ligjvënës është Kuvendi. Ky institucion ka tri funksione: funksionin legjislativ, kontrolues dhe atë përfaqësues. Pra, deputetët të cilët punojnë në Kuvend e përfaqësojnë popullin, ata miratojnë ose nuk miratojnë ligjet, si dhe mbikëqyrin punën e Qeverisë.

Në Kuvendin e Republikës së Kosovës bëjnë pjesë 120 deputetë, 30% prej tyre janë gra kurse pjesa tjetër janë burra. Po ashtu, 100 vende janë të garantuara për deputetë të kombit shqiptar, ndërsa 20 vendet e tjera janë për deputetët nga komunitetet jo shumicë (romë, ashkali, egjiptian, serb, turk, boshnjak).

Kosova është një vend demokratik me sistem parlamentar, ku populli në zgjedhje voton kandidatët për deputetë. Në Kosovë deputetët e zgjedhin Presidentin, ndërsa në vende të tjera që kanë sistem presidencial populli e zgjedh Presidentin.

Ne sot në grupin tonë i kemi ndarë punët që të gjithë të angazhohemi në mënyrë të barabartë dhe të drejtë. Edhe në Kuvend deputetët i ndajnë punët në mes

vete, prandaj janë disa grupe punuese të cilat ndryshe quhen komisione parlamentare. Ndërsa takimet e deputetëve në Kuvend quhen seanca plenare. Në demokraci kemi shumë të drejta. Tanimë edhe burrat edhe gratë kanë të drejta të barabarta si në punë, në familje, ashtu dhe në vendimmarrje.




Kuvendi - Parlamenti




Grupi „Bota“

MIRATIMI I LIGJEVE



E drejta e votës




Respektimi i rregullave të komunikacionit


Ligjet, rregulla që duhen të zbatohen nga të gjithë

Sot në grupin tonë mësuam për demokracinë. Në një pjesë të diskutimit u përfshinë edhe ligjet. Me fjalën ligj kuptojmë një rregull të shkruar që duhet ta zbatojë çdo njeri.

Miratimi ose jo miratimi i ligjeve bëhet në Kuvend. Ligji që propozohet dhe i cili ende nuk është miratuar quhet projektligj. Propozimin e projektligjit mund ta bëjë Kuvendi, Qeveria, Presidenti dhe populli. Populli për të propozuar një projektligj duhet të ketë më shumë se 10.000 nënshkrime. Ligji përveç që mund të propozohet, ai mund edhe të ndryshohet. Ligjet që propozohen ose ndryshohen duhet të bazohen në Kushtetutën e atij vendi. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i një shteti. Ndërsa, ligji me një fjalë është rregullator i jetës sonë dhe të gjithë qytetarëve të vendit tonë.



Ne duhet t'i zbatojmë ligjet



Të drejtat e barabarta për të gjithë



Akti më i lartë juridik

NE VOTOJMË, JU NA PËRFAQËSONI

LEON B. (11), ARIANIT (12), ANISA (11), DION (11), BLERTA (11), LEON A. (11), YLLI (11)

Një votë e jona ka vlerë të madhe për shtetin tonë, sepse me grumbullimin e votave tona, zgjedhen përfaqësuesit e shtetit tonë

Ne si fëmijë, në jetën tonë të përditshme bëjmë zgjedhje të ndryshme, si për shembull: për blerjen e rrobave, shikimin e filmave të ndryshme, zgjedhjen e sporteve dhe lojërave, zgjedhjen e instrumentit të preferuar që kemi dëshirë ta ushtrojmë, e shumë e shumë gjëra të tjera. Për të votuar duhet të jemi të vetëdijshëm se për kënd jemi duke votuar, prandaj është caktuar moshë 18 vjeçare si moshë e duhur për të filluar për të votuar. Arsyeja se pse është caktuar moshë 18 vjeçare është sepse atëherë do të jemi më të vetëdijshëm për zgjedhjen që jemi duke e bërë.

Zgjedhjet shtetërore ndahen në zgjedhje lokale dhe ato

qendrore. Zgjedhjet lokale janë ato zgjedhje që bëhen për të votuar kandidatët për kryetar të komunës, ndërsa ato qendrore janë zgjedhje që bëhen për të votuar kandidatët për deputetë. Në momentin që ne votojmë për ta atëherë do t'u jepet mundësia që të bëhen deputetë. Deputetët në Kuvend zgjedhin Presidentin, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin e një shteti. Ata si kandidatë për deputetë duhet të jenë të drejtë dhe pasi t'i marrin votat tona t'i përmbushin premtimet që i kanë dhënë. Atëherë ne do të besojmë se ata janë me të vërtetë deputetë, të cilët i përmbushin të gjitha premtimet që i kanë dhënë.




Rëndësia e votës sonë



Ne punojmë së bashku



Kutia e votimit



Votimi i hapur në Kuvend

Ne jemi qytetarë të Kosovës dhe meqenëse jetojmë në një vend demokratik, ne kemi të drejtat dhe përgjegjësitë tona të cilave duhet t'u përmbahemi

Në momentin që ne lindim, jemi qytetarë të shtetit të Kosovës. Si dhe për të qenë qytetarë do të duhet të jemi të regjistruar në regjistrin civil dhe të kemi leje qëndrimi për territorin e Kosovës.

Qytetarët e një vendi demokratik kanë disa të drejta të cilat i gëzojnë. Ato janë: e drejta për arsimim dhe edukim, e drejta për të gëzuar mirëqenie dhe shëndet, lëvizja e lirë e shumë gjëra të tjera.

Arsimimi është një e drejtë të cilën të gjithë qytetarët mund ta gëzojnë në mënyrë që të arrijnë të zhvillojnë vendin e tyre. Përmes arsimimit ne marrim njohuri dhe mësojmë aftësi të ndryshme.


Edukimi dhe sjelljet e mira janë shumë të rëndësishme në jetë, sepse pa edukatë dhe nivel të mirë të arsi-

mimit nuk do të jemi të aftë të japim kontributin tonë si qytetarë aktiv.

Shëndeti po ashtu si edukimi është shumë i rëndësishëm, sepse pa shëndet mund të na përhapen sëmundje të ndryshme. Ndërsa, lëvizja e lirë është kur ne jemi të lirë që të lëvizim edhe nëpër vende të tjera.

Përveç të drejtave gjithashtu kemi edhe shumë përgjegjësi. Përgjegjësitë janë gjëra që nuk jemi të obliguar ligjërisht t'i përfundojmë, por është mirë që ne t'i bëjmë. Përgjegjësi mund të jenë detyrat e shtëpisë, të kujdesemi për veten dhe për njëri-tjetrin, etj.

Detyrat e shtëpisë duhet t'i përfundojmë sepse atëherë ne do të pasurojmë mendjet tona dhe mund të forcojmë demokracinë e vendin tonë.



Kosova është shtet demokratik dhe i pavarur



Gazetarët e ardhshëm



Çdo qytetar ka të drejtën e emrit



Të gjithë jemi të barabartë pa asnjë dallim



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Mitrush Kuteli“
Klasa: VI-1
Vendi: Prishtinë